

LIGJ

Nr. 8937, date 12.9.2002

PER RUAJTJEN E NXEHTESISE NE NDERTESA

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka per qellim te krijojze bazen ligjore te nevojshme per vendosjen e rregullave dhe berjen te detyrueshme te marrjes se masave per ruajtjen e nxehtesise ne ndertesat.

Neni 2

Per qellimet e ketij ligji, termat e perdorura kane keto kuptime:

"Ndertese" do te thote nje ngrehine, nje bashkese lokalesh, mjedis banimi, sherbimi e prodhimi me karakter publik ose privat.

"Instalim termik" do te thote bashkese pajisjesh termike se bashku me rrjetin lidhes, qe sherbejne per ngrohjen dhe ftohjen e mjedisit te brendshem te ndertesave.

"Ngrohje qendrore" do te thote nje impiant ngrohjeje, qe furnizon me energji termike nje ose me shume apartamente.

"Ngrohje lokale" do te thote nje impiant ngrohjeje, qe furnizon me energji termike nje grup ndertesash te ndara nga njera-tjetra.

Neni 3

Projektimi dhe ndertimi i ndertesave te realizojze parametrat teknike te nevojshem per ruajtjen, kursimin dhe perdorimin me eficence te energjise. Te gjitha ndertesat qe do te ndertohen pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, te respektojne koeficientin vellimor e normativ te humbjeve termike (Gv), si dhe te parashikojne vendosjen e instalimit termik te ngrohjes qendrore ose vendore.

Neni 4

Instalimet e prodhimit te nxehtesise (gjeneratoret e nxehtesise ose/dhe pompat e nxehtesise) per ngrohjen dhe/ose freskimin e ndertesave projektohen per arritjen e temperatures se ajrit te brendshem, sipas normave te komfortit te temperatures, duke marre parasysh kushtet klimatike zonale dhe anen funksionale te nderteses .

Neni 5

Keshilli i Ministrave percakton normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehtesise ne ndertesa, brenda tre muajve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3484, date 7.10.2002 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Alfred Moisiu